

EUROPA

DREJTOR: ENO TRIMÇEV • KRYEREDAKTOR: GJERGJI VURMO • SHEFE E MARREDHENIEVE ME JAShte: SABINA YMERI

Bullgaria dhe Rumania, anëtarë të BE në 2007



Në përgjithësi Bullgaria dhe Rumania kanë bërë përpjekje të mëdha në përshtatjen e legjislaturës dhe administratës me ligjet dhe rregullat e Bashkimit European. Këto reforma i sollën dy vendet në nivelin e standarteve dhe praktikave brenda BE. Njëkohësisht BE do të jetë e pranishme me ndihmë dhe asistencë për çështjet e mbetura. Në Traktatin e Aderimit ekzistojnë garancitë e nevojshme për të siguruar funksionimin optimal të politikave dhe institucioneve europiane. Si rezultat i progresit të arritur, Bullgaria dhe Rumania do të jenë të afta për të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet e anëtarësisë në BE më 1 Janar 2007. Në atë datë Komisioni pret me padurim t'u urojë mirëseardhjen Bullgarisë dhe Rumanisë si anëtare me të drejta të plota në Bashkimin European.”

Sipas Komisionit European Bullgaria dhe Rumania do të aderojnë në BE në Janar 2007. Presidenti i KE Jose Manuel Barroso deklaroi më 26 Shtator në seancën plenare të Parlamentit European në Strasburg se Komisioni rekomandon që të dy vendet aspirante për anëtarësim, duhet të bëhen anëtarë me të drejta të plota në datën e parashikuar në Traktatin e Aderimit. Pra, sipas Komisionit, nuk është e nevojshme të aplikohet opsioni për shtyrje njëvjeçare të hyrjes në BE. Gjithsesi, Komisioni e shoqëroi rekomandimin e tij pozitiv me një numër masash për të siguruar zgjerimin e qetë nga BE e 25 anëtarëve në atë të 27 anëtarëve. Në këto masa përfshihen direktiva për të dy vendet në implementimin pa vonesa të reformave dhe për mbrojtjen e 25 anëtarëve të BE kundër përhapjes së efekteve të mundshme negative në rast se asnjë prej dy vendeve për...

FAQE 10-11

Fjala e Z.
Olli Rehn në
Parlamentin European

Në këtë numër:

**Parlamenti European miraton
MSA mes Shqipërisë dhe BE**

FAQE 8

**Barroso kërkon pauzë në
zgjerimin e Bashkimit European**

FAQE 9

KE kritikon Beogradin për reformat

FAQE 4

EURO - OPINION

FAQE 16

EU INTERESANTE

FAQE 15